



## BALTIKU: MES MESJETËS DHE MODERNES

7 DITË / 6 NETË, NGA TALIN NË VILNIUS

26 GUSHT - 1 SHTATOR

DITA 1

26 GUSHT 2025

TALIN



Mbërritja në Talin, kryeqyteti i Estonisë. Transferimi për në hotel.

Check-in në hotel është i mundur pas orës 15:00. Ditë e lirë për të eksploruar qytetin në këmbë sipas dëshirës suaj.

Akomodimi në hotel 3/4★: Park


Inn by Radisson Meriton Conference & Spa, ose i ngjashëm me të.

Mëngjes bufe në hotel. Më pas nisim vizitën e qytetit me guidë. Pjesa më e rëndësishme e qytetit është padyshim ajo mesjetare, e ndërtuar midis shekujve XIII dhe XVI, kur Talini ishte ende anëtar i Lidhjes Hanseatike. Muret dhe kullat dy kilometra të gjata që rrethojnë qendrën historike konsiderohen si një nga fortifikimet mesjetare më të ruajtura në Evropë.



Ndër atraksionet e shumta të Talinit, do të admirojmë Sheshin e Bashkisë, të rrethuar nga Kalaja e Toompeas dhe Kisha Ortodokse e Shën Nikollës.

Dreka e lirë. Pasdite e lirë për të zbuluar bukuritë që ofron qyteti. Akomodimi në hotel 3/4★: Park Inn by Radisson Meriton Conference & Spa ose i ngjashëm me të.



**DITA 3**

**28 GUSHT 2025**

**TALIN – PARNU – RIGA (320 KM)**



Mëngjes bufe në hotel. Nisja për në Riga me autobus komod. Gjatë rrugës do të ndalojmë në vendpushimin bregdetar të Parnus, i karakterizuar nga plazhet e tij me rërë të bardhë. Mbërritja në

Riga dhe akomodimi në hotel 3/4★: Islande hotel ose i ngjashëm me të.

**DITA 4**

**29 GUSHT 2025**

**RIGA**

Mëngjes bufe në hotel. Do të fillojmë ditën me një vizitë të qendrës së Rigës, kryeqyteti i Letonisë, i njohur si perla e Baltikut. Do të vizitojmë kështjellën e lashtë të urdhrit livonian, katedralen, kishën e Shën Gjonit dhe Shën Pjetrit, portën suedeze dhe kullën e barutit, bastionet e Gildës së Madhe



dhe të Vogël, grupin e shtëpive të njohura si tre vëllezërit dhe parlamentin. Dreka e lirë. Pjesa tjetër e ditës e lirë për të shëtitur në këtë qendër të bukur historike. Akomodimi në hotel 3/4★: Islande hotel ose i ngjashëm me të.

**DITA 5**

**30 GUSHT  
RIGA – RUNDALE – KODRA E KRYQEVE – VILNIUS (380 KM)**

Mëngjes bufe në hotel. Nisja për në Vilnius. Gjatë rrugës do të ndalojmë në kështjellën e Rundales, e konsideruar një kryevepër e artit arkitektonik barok letonez, e ndërtuar në fund të shekullit XVI. Dreka e lirë.



Do të vazhdojmë rrugën dhe do të ndalojmë në Kodrën e Kryqeve pranë Jurgaiciait. Pelegrinët vijnë nga e gjithë bota për të shtuar kryqe, në ato mijëra që tashmë gjenden aty. Mbërritja në Vilnius. Akomodimi në hotel 3/4★:

Amberton Vilnius ose i ngjashëm me të.

**DITA 6**

**31 GUSHT 2025**

**VILNIUS – KALAJA E TRAKAIT – VILNIUS (80 KM)**



Mëngjes bufe në hotel. Vilnius njihet për arkitekturën e tij të bukur, trashëgimi e UNESCO-s. Do të fillojmë ditën duke vizituar katedralen, universitetin dhe kishën e Shën Pjetrit e Shën Palit.

Do të vazhdojmë për në Trakai, kryeqyteti i lashtë i Lituaniës, i famshëm për pozicionin e tij midis pyjeve dhe liqeneve të mrekullueshme *(për arsye operative kjo vizitë mund të zhvillohet edhe një ditë më parë)*. Akomodimi në hotel 3/4★: Amberton Vilnius ose i ngjashëm me të.



**DITA 7**

**1 SHTATOR 2025**

**VILNIUS – NISJA**

Vilnius. Mëngjes bufe në hotel. Transferimi për në aeroport.

**<FUNDI I SHËRBIMEVE >**

## **PËRFSHIHEN NË ÇMIM**

- Fluturimi Tiranë – Talin (1 cabin bag 55 cm X 40 cm X 23 cm + 1 personal item (8 kg total)
- Fluturimi Vilnius - Tiranë
- 6 netë akomodim në hotelet e sipërpërmendura
- 6 mëngjese në hotele
- Guidë / shoqërues në gjuhën italiane
- Shoqërues shqiptar nga agjencia
- Autobus GT sipas programit
- Vizitë me guidë: Vilnius, Riga, Talin
- Hyrjet: Kalaja e Trakait dhe Pallati i Rundales
- Sigurimi i shëndetit në udhëtim

## **NUK PËRFSHIHEN NË ÇMIM**

- Drekat dhe darkat
- Pijet gjatë vakteve
- Shërbimi i transportit të bagazheve
- Gjithçka që nuk është përmendur më sipër